



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:229488  
Datë: 12.03.2024  
Numri i dokumentit: 05440169

**A.nr.2574/2022**

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses, ....., nga komuna e ....., në adresën ....., të cilën e përfaqëson me autorizim ..... në adresën ..... , kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Pensioneve, Prishtinë, me bazë juridike, “anulimi i vendimit”, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të autorizuarës së palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 04.03.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.** Aprovohet si bazuar kërkesëpadia e paditëses, ....., nga komuna .... dhe anulohet vendimi i datës 16.09.2022, i të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transferave Prishtinë, Departamenti i Pensioneve, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

**II.** Obligohet e paditura MFPT/DP, të veprojë nga pikëpamja juridike e kësaj gjykate si dhe nga vërejtjet e dhëna lidhur me procedurën.

**III.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

**A r s y e t i m**

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA –së, në prani të autorizuarit të palës paditëse e në mungesë të palës së paditur e ftuar më ftesë të rregullt gjyqësore (Provë: të fletë-kthesa e datës 14.02.2024).

Paditësja me padinë e datës 04.11.2022, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet si e bazuar padia e paditëses ..... dhe të anulohet vendimi i datës 16.09.2022 si i kundërligjshëm. Obligohet e paditura Qeveria

e Kosovës –Ministria e Financave ,Punës dhe Transfereve Departamenti i Pensioneve që paditëses ..... të ia njohë të drejtën në pension familjar. Detyrohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti i Pensioneve ti bartë shpenzimet e procedurës Administrative në lartësinë e tyre reale të cilat i cakton Gjykata. Tutje e njëjta në padi ka theksuar se Organi Administrativ Vendimin e datës 16.09.2022 e ka mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr.04/L-131 respektivisht Neni 12 i këtij ligji. Arsyetimi i dhënë nga departamenti i Pensioneve është i paqëndrueshëm, sepse nuk ka asgjë të bëjë me trashëgimin apo me ligjin mbi trashëgimin .Tutje theksohet se, organi i shkallës së dytë ka mbështet vendimin në dispozitat e nenit 12 të Ligjit Nr.04/L-131 duke mos e sqaruar dhe arsyetuar me saktësi se pse kjo dispozitë ligjore e përjashton paditësin dhe të drejtën e tij në pension Familjar. Paditësi gëzon të drejtën në pension Familjar konform dispozitave të Ligjit nr.04/L-131 edhe atë Neni 3 par 1 pika 1.9 “Pensioni familjar-Pensioni i rregullt mujor i paguar për anëtarët e familjes në rast të vdekjes së të punësuarit që kanë qenë në marrëdhënie pune, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj. Andaj për arsyet e paraqitura më lartë, bazuar në provat e bashkangjitura dhe mbështetur në dispozitat ligjore kërkon nga Gjykata që pas administrimit të provave të prezantuara në procedurë të aprovohet si e bazuar padia e paditëses .....

E autorizuar e paditëses në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe në fjalën e saj përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimi kontestues i të paditurës i datës .16.09.22 si i pabazuar në ligj dhe po ashtu të obligohet e paditura që paditëses .... t'ia njoh të drejtën në pensionin familjar. Kërkoj shpenzimet e procedurës.

E paditura në përgjigjen në padi të parashtruar në gjykatë me datën 18.10.2023, e ka kontestuar, padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, duke kërkuar nga gjykata që Refuzohet kërkesëpadia e paditëses ,në tërësi si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi Vendimi i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve. Tutje enjëjta ka theksuar se në bazë të Aktvendimit A.nr..... të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ e paditura është detyruar që të paraqesë përgjigje në padi, prapësimet procedurale dhe të deklarohet se a e pranon apo konteston kërkesëpadinë e paditësit .Departamenti i ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe ka konstatuar se paditësja nuk i plotëson kushtet gjegjësisht nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme për të përmbushur kriteret për të qenë përfitues të pensionit familjar, ashtu si përcaktohet sipas dispozitës ligjore neni 12 të Ligjit 04/131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, ashtu që kërkesa e paditëses refuzohet, si e pa bazuar ,ngase nuk janë plotësuar kriteret e parapara me ligj.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 04.03.2024, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi i dt.16.09.22, vendimi tdt.17.05.22, ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile për ... dt.31.10.22, certifikata e vdekjes për .... dt.10.05.22, certifikata e martesës e dt.13.10.21 datë e lidhjes së martesës 20.06.22, vërtetimi i dt.27.10.21, vendimi i dt.26.10.21, librezë e punës me nr.130703, vërtetimi

i dt.30.10.1996, kopja e letërnjoftimit për .... dt.24.07.20, certifikata që nuk posedon paljushmëri dt.05.01.22, dëshmia e vdekjes 05.01.22, kontrata e punës me nr.7769/0 dt.01.03.14, aktgjykimi i GJ. Kushtetuese me nr.AGJJ 2113/23.

Gjykata duke vlerësuar vendimet e goditura me padi, në përputhje me nenin 44.3 dhe nenit 67 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thënieve të padisë, përgjigjes së dhënë nga e paditura ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e **bazuar**.

Me vendimin e datës 17.05.2022, është refuzuar kërkesa e për njohjen e të drejtës në Pension Familjar, me arsyetimin se e njëjta nuk i përmbush kriteret e parapara me nenet 1,2,4 si dhe paragrafët 1,2,3 të nenit 12 të Ligjit 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti andaj në kuptim të paragrafit 4.5 të nenit 6 të U/A-nr.07/2015 e ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar

Paditësja ka paraqitur ankesë me nr.03/517 me datë 01.08.2022, kundër vendimit të Departamentit të Pensioneve . E paditura me vendimin e datës 16.09.2022, e ka refuzuar ankesën e paditëses për njohjen e të drejtës në Pension Familja, për arsye se nuk janë plotësuar kriteret ligjore të përcaktuara me nenin 12 të Ligjit Nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti.

I pakënaqur me këtë vendim, paditësja, me datën 04.11.2022, ushtron padi në këtë Gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata fillimisht iu referuar dispozitës së nenit 3 paragrafi 1.9 të Ligjit Nr. 04/L-13 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti me të cilin është përcaktuar që” Pensioni familjar - pensioni i rregullt mujor i paguar për anëtarët e familjes në rast të vdekjes së të punësuarit, që ka qenë në marrëdhënie pune, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj”.

Me nenin 12 po këtij ligji është përcaktuar që “Të drejtën për pension familjar e realizojnë të gjithë ish shfrytëzuesit e pensionit familjar të cilët janë nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare dhe të cilët realizimin e kësaj të drejte e dëshmojnë me Vendim apo fletëpagesë të pensionit që tregon se kanë qenë shfrytëzues të pensionit familjar, para datës 01.01.1999, sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83), ndërsa paragrafi 2 parasheh që” Sipas paragrafit 1 të këtij neni, të drejtën në pension familjar e realizojnë, anëtarët e ngushtë të familjes, të ish të siguruarit që ka vdekur pas datës 01.01.1999, të cilët dëshmojnë se i siguruari ka paguar për pesëmbëdhjetë (15) vite kontributet për stazhin pensional, ndërsa paragrafi 4 përcakton se “Të drejtën në pension familjar, sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, e realizojnë: 4.1. bashkëshorti/ja, deri në moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç, që dëshmojnë se janë në kurorë si dhe nuk janë në marrëdhënie pune ose të vetëpunësuar; 4.2. Bashkëshorti/ja, nën moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare, i shpallur invalid i

përhershëm dhe i pa aftë për punë; 4.3. *fëmijët deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare përkatësisht njëzet e gjashtë (26) vjeçare, nëse ofrojnë dëshmi përkatëse për vijimin e shkollimit të rregullt universitar.*

Sipas dispozitave të nenit 48, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, paragrafi 1 përcakton se, “Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim”, ndërsa paragrafi 2 thekson, se: “2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij, ndërsa në arsyetimin e të paditurës, shihet qartë se nuk janë respektuar këto dispozita.

Gjykata konstatoi se, MPMS, ka nxjerrë vendim të datës 16.09.2022, duke vepruar sipas ankesës ndaj vendimit, me të njëjtin numër të dosjes, të datës 17.05.2022, me të cilin refuzohet kërkesa, respektivisht ankesa e ankueses. Vendimi ka të meta në arsyetim, siç është paraparë me dispozitat e nenit 48, paragrafit 1, nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, dhe paragrafit 2 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA); ka zbatuar gabimisht dispozitën e ligjit material, respektivisht nenin 12 të Ligjit nr. 04/L-131, dispozitë kjo, mbi të cilin është bazuar arsyetimi i vendimit.

Gjykata si rregull konfliktin administrative e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Në këtë mënyrë, vendimi konsiderohet se përmban të meta për shkak të të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave ligjore, të cilat pamundësojnë shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit ose edhe vendosjen në mënyrë meritore nga ana e gjykatës, andaj, gjykata konform nenit 43.2 të LKA-së, vendosi që çështjen ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim, gjykata e obligon organin e paditur, në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna

në këtë aktgjykim, dhe pasi t’i mënjanojë të metat e cekura, të merr aktvendim të drejtë, të bazuar, udhëzues për palën paditëse në mbrojtje juridike dhe palët të njoftohen me kohë.

Lidhur me shpenzimet procedural gjykatave vendosi në pajtim me nenin 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti për Çështje Administrative,  
A.nr.2574/22, datë 04.03.2024

G j y q t a r e  
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.